

**VENDIM**  
**Nr. 439, datë 18.7.2018**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË  
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT  
“NDËRTIM I RI I SHKOLLËS TIP 2 + TIP 4 NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 11,  
SHESHI 11/1”, NË BASHKINË TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtim i ri i shkollës tip 2 + tip 4 në Njësinë Administrative nr. 11, sheshi 11/1”, në Bashkinë Tiranë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit që paraqitet në tabelën nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi, me një vlerë të përgjithshme prej 206 014 556 (dyqind e gjashtë milionë e katërmëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 206 014 556 (dyqind e gjashtë milionë e katërmëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2018, miratuar për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Tiranë.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

LISTA E PASURIVE PRIVATE  
 ZËRI KADASTRAL: AKTIVITET PRIVAT, SHTËPI BANIMI ETJ.,  
 QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTT  
 “NDËRTIM I RI I SHKOLLËS TIP 2 + TIP 4, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 11, SHESHI 11/1”,  
 NË BASHKINË TIRANË

| Nr. | ZK   | Nr. i pasurisë | Adr. | Pronari                                                                  | Sipërf. truall | Sipërf. ndërt. | Çmimi i truall lekë/m² | Çmimi i ndërtimit lekë/m² | Vlera e truallit, lekë | Vlera e ndërtimit, lekë | Vlera e truallit dhe e ndërtësës (lekë) | Shënime |
|-----|------|----------------|------|--------------------------------------------------------------------------|----------------|----------------|------------------------|---------------------------|------------------------|-------------------------|-----------------------------------------|---------|
| 1   | 8320 | 1/621          |      | Diana Aleksandër Hoxha, Robert Aleksandër Dako, Viktoria Aleksandër Ruli | 8.963          | 0              | 22,985                 | 0                         | 206,014,556            | 0                       | 206,014,556                             |         |